



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT**

DATA/DATUM/DATE	21.02.2023
NR/BR/NO	02/66
PËR/ZA/TO	Kuvendi i Komunës së Shtimes
NGA/OD/FROM	z. Reshat Gashi - Kordinator i grupit punues për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje për Komunën e Shtimes Koordinatori i Njësitit Kundër Diskriminimit dhe Zyrtar per Barazi Gjinore për Komunën e Shtimes Koordinator i Mekanizmit Kordinues kundër Dhunës në familje
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Faruk Beqa - Nënkrjetar i Komunës së Shtimës – Udhëheqës i grupit punues
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Draft-Strategjia dhe Plan i Veprimit Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Shtimes 2023-2025

Në mbështetje të agjendes për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje dhe kërkesave që dalin si kriter obligues për komunat, bazuar në vendimin e themelimit të grupit punues për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje për Komunën e Shtimes, datë 04.11.2022, Nr. protokolli 02/698, po e dergoj draft materialin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme, fillimisht të dalë në dëgjim publik dhe më pas për miratim në Kuvend.

Strategjia Komunale dhe Planit i Veprimit Kundër Dhunës në Familje është dokument strategjik dhe operativ, që bazohet në rezultatet e procesit të vlerësimit të rrezikut për Dhunën në Familje si dukuri në shoqëri, si dokument i brendshëm miratohet përmes Kuvendit Komunal.

Dokumentin e plotë do ta dërgojmë me materialin e Kuvendit, ndërsa prezantimin do ta bëjmë në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Ju ftojme që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik.